

Përshendetje.

Nisur nga kërkesa juaj e datës 08.06.2020, drejtuar Bashkisë Shkodër me e.mail, në të cilën bazuar në ligj nr.119/2019 “Për të drejten e informimit” kërkonti informacion për politikën e Bashkisë Shkodër për mbledhësit e mbetjeve të riciklueshme dhe bllokimin e mjeteve motorrike të tyre nga ana e policisë së shtetit, ju bëjmë më dije se:

Ndër funksionet e bashkive të përcaktuara me ligj nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” është dhe ai i fushës së infrastruktures dhe shërbimeve publike, ku ndër të tjera është dhe **mbledhja, largimi dhe trajtimi e mbetjeve të ngurta dhe shtëpiake.**

Mbledhja dhe largimi i tyre bëhet nga subjekte private, bazuar në procedurat e prokurimit publik. Trajtimi i mbetjeve bëhet në landfillin e Bushatit.

Nëse, mbledhësve të mbetjeve të riciklueshme dhe konkretisht të komunitetit rom, u janë bllokuar mjetet motorrike nga ana e policisë së shtetit, kjo është bërë në zbatim të “Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë”

Në faqen eeb të Bashkisë Shkodër, në linkun

http://www.bashkiashkoder.gov.al/web/plani_i_zhvillimit_lokal_te_komunitetit_rom_dhe_egjiptian_1566.pdf, do të gjeni informacion për komunitetin rom dhe egjiptian

Për çdo paqartësi, mbetimi në kontakt

Dajana Cico

Koordinatorë për të Drejten e Informimit

Bashkia Shkodër